

BIBLIOTEKA

E

8JH-1

N 33

SHËTIT

GJIROKASTËR

Arqile
Ndini

TEK TI
JETON
DITA
poezi



81H-1

N 33

Argjile
Ndini

AMOHF ALBANI



TEK TI
JETON
DITA

poezi

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

AMOHF ALBANI

Rrugët

Të gjitha rrugët
kanë një fillim:
kanë lindur me baltë.

Mijëra duar
i ripërtëritën me gurë,
i zgjeruan me kalldrëm,
i shtruan me asfalt.

Hapi im
lulëzimin u zgjon
nëpër trupin e gjatë.

Për radiorevistën e orës 20

Drin,
gurgullimë e vjetër,
rrjedhje e gjatë
në shekuj,
nëpër këmbët e maleve.
Ka kohë që trupin tënd
e shtrydhim nëpër duar
të rizbulojmë dritën.
Ka kohë që rrotull teje
malet i ngarkojmë në makina të rënda.

Lëvizin,
zhvendosen
peizazhet mbi brigje
për ta bërë rimundjen tënde
të gjallë,
të vërtetë,
rimundjen tënde që unë e incizova
në intervistën e punëtorëve
te Gryka e Melgunit,
për radiorevistën e mbrëmjes
të orës 20.

Ngjarje familjare

Motra ime
lindi një fëmijë.

Atëherë babai
pëshpëriti
se po bëhej plak.

E nëna tha:
u bëra
përsëri nënë.

Në duart e njoma
i vuri pak copëza plisi
të lagura në shi.

Toka e ëmbël
t'i lidh lule
në udhën e tij.

Vëllai
këputi fletët e hardhisë,
çeli një dritare
nëpër hapësirë.

Dhe tha:
tani qyteti
zgjeron frymëmarrjen
nga vogëlushi Ermir.

Moli Zero

Moli Zero,
si gur
të rëndoi ky emër.

Fëmijëve që lindin
prindërit tanë
i vënë një emër të blertë,
emrin e një mali që mbart krenari,
emrin e një lumi që buron jetë.

Kush të quajti
Zero?

Ti
djersë e njeriut të thjeshtë,
ashtu kockëthërrmuar
më mbajte në kurviz,
më ngrite
më lart se deti.

Nën këmbët e mia
shkumëzonin valët,
shkruanin zhurmën e tyre
të vërtetë.

Mbi trupin tënd,
me peshkatarët,
barkat e ngarkuara
i lidha si kuaj.

Shumë herë
ke qenë stacion i parë,
na zgjove ngröhtësinë e tokës.
Asnjëherë s'e njohe braktisjen
si një breg i huaj.

Moli Zero.

Rrëshqet
në fund të valëve,
si një guaskë e thyer
ky emër i vjetër.

Punëtorët rindërtojnë
gjymtyrët e tua
të copëtuara nga lufta,

krijojnë
fytyrën tënde të qartë.

Disa metra më shumë
shëtis mbi kaltërsitë,
nga deti
disa metra më shumë
përsëri
ngrihem më lart.

Prill

Karafilat

kanë çarë gonxhet në dritare
me petalet e ndezura
të kuqe,
shpuzë.

Ajri i freskët

më kaltëron sytë,
më fërshëllen në buzë.

Unë vrapoj përmes
shpërthimit të barit.

Më thërrasin

lodrat çapkëne të vajzave,

dallëndyshet nga foletë e reja
në ballkonet e porsalyera;
biçikletat nëpër asfalte
nga dimri të harruara.

Unë vrapoj
t'i afroj lajmëtarët e pranverës,
pranë vetes,
në duar.

Nuk e di
kë të vendos në zemër
të rregulloj lëvizjen
e hapave të mi,
të nxituar.

Të dielën ra shi

**Të dielën
gjithë ditën ra shi.**

**U lagën sheshet.
Zgjasin fletët,
rrembejnë rrëketë e holla
pemët.**

**Rrënjët fryhen
e gjallërohen në qetësi.**

Pak nga pak
malet lidhën kokat
me shamitë e mjegullave
si malësorët.

Digjen vetëtimat në një klarinetë.
Në një def
hidhen e kërcejnë retë.

Duart e nuses
si ylberë
u lakuan nëpër rrugë
me dasmorët.

V unoi

1:

Përpara syve të mi
fshatit i dogjën shtëpitë, gjymtyrët ia vranë
një ushtri me këmisha të zeza
duke kërkuar djemtë
partizanë.

Nën muret e përcëlluara nga flaka
gratë oxhakët i përgatitën për zjarr,
degët e ullirit i bënë çati
dhe ngulën gozhdë nëpër
trarë.

Do t'u vinin bijtë e nënat përsëri
i ndihmoja të varnin nëpër mure
një pushkë, pak misra, një djep
që ruan përkundje dhe rrit
fëmijë.

2.

Akoma isha i vogël kur një ushtri
me kryqe të thyera, me klithma të sërta
duke kërkuar djemtë partizanë
shkeli fshatin nëpër kalldrëmet

e pjerrta.

Në heshtjen e grave
i prenë të gjitha pemët,
shtëpitë i ridogjën,
fshatit rrënjëdalë gjymtyrët

ia rivranë.

Dhimbjen e thithi deti,
dhimbjen e thithi ulliri,
thërrmijat e panumërta të dheut
të enjtura
nga hiri.

Dhe hakmarrja duart nguli në tokë,
mbi gurët e djegur.
Liria këtu është jetë,
një gjak
i pavdekur.

Ju flas për Pogonin

Ja, ku lindi dielli
në shpatullat e Nemërçkës,
si shkëlqen
pas brinjëve të gërryerë nga ujërat,
nëpër dritaret e mëdha.

Dëborën e shkrirë
nga gishtërinjtë e prillit
e hodha në vazot e luleve
dhe pashë
nëpër damarët e gurit
shumëzimin e rrënjëve
të kërcellit të hollë të grurit.

Nuk i kam njohur
si deformohen duart
nga ndarja e mërgimit,
nuk më kujtohet
si është një fytyrë e rrudhur,
një fytyrë e tharë
nga pika e lotit
që digjte si zjarr.

Në kujtesë
akoma është e freskët
përmbysja e ashpër
e kabanave të rënda

prej bronzi,
lehtësimi i mureve nga kryqet.

Ju flas për rrugicat
Ku janë lidhur plagët,
ku lëkunden djepet
dhe toka nuk shkëputet
nga toka në Pogon,
nuk thërrmohet plisi
nga plisi
kur jeta rritet
me dashurinë e njeriut
në vatrën e çdo fisi.

Kthehesha i vetëm në shtëpi

Kthehesha natën, vonë, në shtëpi
nëpër rrugët që ka ngrënë
këpucët e mia.

Papritur «Natën e mirë» më përshëndeti
një njeri.
Si zogj m'u larguan
lodhja dhe vetmia.

Aj, iktë,
nën neonët e përkulur mes pemëve.
Në të gjitha fjalët
hapi dyert e u shtri,

erdhi e më pushtoi sytë.

Kthehesha i vetëm në shtëpi,
hyra vetë i dytë.

Përsëri në Vlorë

E putha nënën,
i përqafova vëllezërit.

Malli im
u pjesëtua te sendet e dashura
nëpër dhomat e ngrohta
dhe dola në rrugë.

Si mund të rrija
pa i takuar shokët?
Si mund të rrija

pa e takuar detin,
pa u ngjitur tek parku «Liria»
të përshëndetësja
edhe me palmat më të largëta
në rrethinat që zgjatojnë qytetin.

Përtej mureve
janë shënjat e mia,
janë duart e mia të njoma
me erën e fortë të naftës,
me njollat e njohura të hekurit,
me plagët e para nga kuckat

të spërkatura nga balta,
të lagura nga shiu;

Janë hapat e mi të lehtë
të ngarkuar me guximin e zjarrtë
që ma shndërronin në vendosmëri,
kur dashuroja,
çdo ndjenjë të bukur
që krijonte tek unë
një zemër të çiltër njeriu,
në stinët
kur largohesha nga ty, fëmijëri.

Sa herë iki me shërbim

Shtëpinë time
e kanë rrethuar ullinjtë.

Sa herë iki me shërbim,
nga degët
këpus një gjethe të gjelbër.
Nëpër rrugë ë ruaj
si puthjen e nënës
fëmijët.

Të fundit më përcjellin
dhe përsëri
të parët më presin
ullinjtë.

Meditim në stacionin hekurudhor

Kryqëzohen trena,
kryqëzohen udhëtarë.

Shuajnë mall
fjalët e lëna dikur në mes.
Sirenat e nisjes
përgjysmojnë diçka.

Shinat
si dy duar
pas një udhëtimit të gjatë
takohen në stacion,
kryqëzohen
për të lindur rrugë të reja
më të mëdha.

E pyeta fqinjën

E pyeta një ditë
fqinjën e pallatit tim,
përse u thotë nuseve:
— Dritë jeni e bëfshi dritë!

Ajo qeshi e më tha:
— Deti
është më i bukur me dallgë,
jeta me fëmijë...

Çast nga Berati

Një mbi një
një shtëpi
me gurë të bardhë,
me fytyrë nga dielli,

Një dritare e hapur
si sytë e ditës,

Një ballkon
me fëshfërimën e lehtë të ajrit
nga frymëmarrja e drurëve

që gjallërohen
në krahët e dritës.

Një mbi një...
Jeta ngjitet e ngjitet.
nëpër gurë bën rrugë,
ngre shkallë.

Hap pas hapi
lëvizi gjaku
e lulëzoi
një mal.

Në mbrëmjen e 6 gushtit, 1942

Prapa dyerve
komunistët përkulur mbi letra,
shkruanin trakte,
fletëthirrjet e kuqe të lirisë.

Teli¹⁾ në trup
i futi të gjitha.

Lamtumirë tha
dhe iku
nëpër «coprifuocon» e shpallur
si një kufi vdekje
në mbrëmjen e gjatë.

1. Teli Ndini — dëshmor i parë i Vlorës.

Kalldrëmet fshihnin
fëmijët e zbathur,
gëzhojat të përgjakura,
binin nëpër baltë.

Lamtumirë.

Ndarjet e vogla
i bënim nyje,
lidhnim rrugët e mëdha.

Dhe hidhnim prag më prag
një thirrje,
një trakt.

Rrisnim rrënjët e grushtit
ngritur nga hakmarrja,
ndezur nga uria.

Pas hapave tanë
lëviznin patrullat,
përgjonin projektorët,
copëtohej mbrëmja
në çdo skaj nga bajonetat.

Pas hapave tanë
urrejtja
shtigjet nuk i humbi.

Me plumbat e Telit
gjëmoi e ngarkuar,

foli nëpër krisma
foli e...

Shtëpitë hapën dyert,
ulën kokat
mbi Telin e rrëzuar.

Në vijat e buzëve
u shtri
një buzëqeshje e madhe
si vetëtimë nëpër re.

E, kuptonim ne, të varfërit,
dhe i flisnim
vetëm ne.

Hyrje për një radioreportazh nga miniera «Guri i kuq»

Në fytyrën e njeriut
çdo çast vizatohet jeta.
Ajo në çdo çast
ligjëron shënjat e veta.

Ja, në sytë e minatorëve,
të çeta si kristal,
nëntoka zemrën ka harruar,
nëntoka është e gjallë.

Male

Përherë tek ju
kemi vënë zemrën;
kemi mbështetur kokën.

Nga trupi
s'e kemi ndarë
dashurinë për tokën.

Përherë tek ju
zbulojmë madhësitë.

Gurë-gurë
u marrim brinjët
dhe i bëjmë themele
për shtëpitë.

Dëshira e fundit e këngëtarit të grupit të Himarës

Më vini një lule limoni
në gishtat e rrudhur,
mos më mbyllen sytë.

Një valë,
vetëm një valë
në buzët si zjarr.

Ngrimani pak kokën
të dëgjoj detin
kur këndon në brigje.

Ison ma qëndisni
në jelekun e zi
dhe fustanellën e bardhë.

Në ditën e dasmës

Në ditën e dasmës
mbeti e hapur porta jonë.

U harruan trokitjet,
tringëllima e fortë e ziles.
Çelësi i saj
u harrua diku.

Asnjë çast,
deri në mëngjes,
porta nuk u mbyll.

Nën harkun e bardhë,
në orët e natës,
çdo njeri
ndizej si yll.

Nëpër rrugët e tua

Nëpër rrugët e tua,
Kosovë,
me njëra-tjetrën
duart bashkohen,
bëhen krahë të shqiponjës
gishtërinjtë e shtrirë drejt,
pëllëmbët që gërshetohen.

Krahë të shqiponjës
në sytë e tu të përflakur.
Me zërin tënd
në çdo bjeshkë me emrin babë,
në çdo plis me emrin nënë,
o gjak
që riprodhon rrënjët!

N j o h j e

Kjo është rruga e shtëpisë,
e dashur!

Këtej kalojnë
peshkatarët tek anija,
ndezin motorët
kur muzgu bëhet i kuq
si faqet e tua nga dashuria.

Në mëngjesin e rilindur,
këtej kalojnë fëmijët
me hapa të bashkuara
dhe mbledhin nëpër rërë
guackat e vetmuara.

Ja, ullinjtë.

Dielli i dimrit i ka argjenduar.

Pikë-pikë nxijnë kokrrat

në trungjet e deformuar

dhe fidanët e rinj.

A e di moshën

kur lulëzojnë

agavjet mbi shkëmbinj?

Sonte

kam dëshirë të flas papushim

po nuk dua

t'i zgjatoj fjalët

të shkurtojnë ditën.

Dhe hesht pranë teje
ta futësh në sy,
ta ndiesh në dejet e tua
peizazhin e vendlindjes sime
që gjallon në çdo stinë.

Kronikë nga viti 1920

Kryqëzorët ushtarë hodhën
nën Shashicë.
Të na varnin
në degët e rrapeve,
të na vrisnin
në gjembat e telave.

Pllajat u rrëqethën
nga predhat,
nga kujet,
nga mallkimi i grave
në muret e djegurë të kasolleve
me tyta të nxehta pëshke!

Nëpër kryqëzime rrufesh
me një grusht plumba
dhe pak thika
ikëm grykave,
brinjë më brinjë.

Nuk na lanë
krismat të flemë,
nuk na lanë
topat të rrimë.

Me ty donim,
o Vlorë e bukur,
të jetonim
nën një gunë me lirinë.

Pisha flamur

Ndaluni
dhe vështroni
kur të kaloni në Llogora
Pishën Flamur,
Një pemë e gjymtuar
vetëm me një krah.

Në trupin e saj të lartë
është çjerrë lëkura
nga thonjtë e erës.

Bisqet e njoma
nga erërat u thanë.

Brenda gjoksit
pisha
mbronte jetën
dhe shpresat nuk u çanë.

Përmes dhimbjes
në majë të trungut lakuriq,
zgjati një dorë,
shpalosi pak gishta.
Në hapësirat e kaltëra
botës i foli
me gjethet e brishta.

Me një fije bari
zogjtë
atje krijojnë foletë.
Dita e lodhur atje fjeti.

Qielli ulet,
thith blerimin
dhe supet e buta mbështet.

Përballë erërave
gjethet rilindin vetveten,
valvitje flamuri,
që nga lindja
deri në vdekje
me fytyrë nga deti.

Mandarina

E dua gjelbërimin tënd,
mandarinë e vogël,
gjethet e ngushta
kur ripërtërihen
si një pyll i vërtetë.

Ti
u zgjate kaq shumë,
mërmërimë e ëmbël në xham,
sa dritaren e dhomës
pëllëmbë, pëllëmbë
ma errësive krejt.

Po mua
sytë më thahen
edhe për kaltërsinë e 'qiellit,
për çerdhet e zogjve
nëpër drurë,
për zhurmimin e rrugëve
pas krahëve të tua.

Në trupin tënd
dora ime
është një rrënjë e blertë.
Kur t'i pres
pjesët e shtrembëra
bëhesh më e fortë,
rritësh më e drejtë.

Si ta marr ujin?

Ej, djalë i vogël,
hiqi se u tremba
dy qentë nga rruga,
të kaloj nga tända!

Çezma është prishur
dhe do shkoj në krua
të marr ujë me shtëmbë,
për babanë e dua.

Nën degët e rrapit
po më pret te dera,

në duart me baltë
i buit pranvera.

Po ma zure rrugën
nata hënën zgjon,
babai në shtëpi
del e më kërkon.

Lidhi të dy qentë
të kaloj nga tända!
Si ta marr ujin
po m'u thye shtëmba?

Kur më vdiq babai

Për herë të parë
unë pres në dhomë
shumë njerëz që s'i njoh.

Për herë të parë,
kur ëndrrat e mia çelnin sytha,
ndjeva
gërryerjen e hidhërimit
të më rrëmbente
një pjesë të vetes.

Për herë të parë
ndjeva

ndarjen që lind largësinë,
si shuhet një jetë,
që më mësoi
të eci në rrugë
me ndershmëri
e të pastër të ruaj rininë.

U besova
fjalëve të babait
se vdekja është një thikë
që zemrën godet pa mëshirë.
Mund të marr nën dhé njerinë
por jo emrin e mirë.

Skicë

Nuk mund ta kuptosh
lumin
pa vrapin e ujit
në pëllëmbët e brigjeve.

Pa valën që ndjek valën
nëpër trup.

Nuk mund ta kuptosh
pyllin
pa dialogët e gjethëve
në pemë.

Pa bashkimin e drurëve
sup më sup,

Asnjëherë jetën
nuk mund ta kuptosh
si ndërton vazhdimësinë
pa mëngjesin që vetëtin.

Pa vërshimin e zërave në rrugë
që shpejtojnë
qarkullimin e gjakut tim.

Në kripore

I humbas pulëbardhat,
këtu
i humbas edhe dallgët.
Punëtorët
copa-copa e ndajnë detin
në qindra katrorë.

I kam humbur pulëbardhat,
i kam humbur edhe dallgët,
thelbi i detit
në mijëra kristale kripe
më shkëlqen në dorë.

Nga fëmijëria

Me një tullë të përgjysmuar
dhe një kapele
me letra revistash të grisura
imitoja makinat në përgjethje me rërë,
nën katet e ngritura;
thërrisja mijëra,
mijëra ëndrra.

Në gishtat e ngrohtë të jetës
i ngrita në këmbë si fëmijë,
nuk i largova kurrë nga zemra.

Mbrëmjet e të dielave

Mbrëmjet e të dielave
i mbyllin
me zhurmë të butë,
në agjencinë e udhëtarëve,
sportelet e biletarisë
si qerpikë të lodhur.

Mbrëmjet e të dielave
dendësojnë lëvizjet
dhe njerëzit
në bulevardet e qytetit
që s'u bënë kurrë të heshtura.

Projektojnë
filma të bukur
në ekranin e televizorit,

kur mbledh në çantën e vogël
rrobat e mia të hekurosura.

Nesër
përsëri do të iki larg
dhe nëna
herë me qetësi,
herë me pak zhurmë
të dashurën time
ta quajë nuse
më kërkon në shtëpi.

Ta përkëdhelë,
t'i prekë fytyrën e njomë,
t'i buzëqeshë
jetës që nuk vyshket
kur ka rini.

Vajzat me drapër

Te halat e kallirit
më ngeci shamia.
Udhës për në fushë
vijtë shoqet e mia.

Tokë, ta kemi borxh
gëzimin që rilind.
Në grunajë humbasin
vajzat me drapërinj.

Shoqet duajt lidhin,
mes fushës nxitohen,
i arrij por prapë
ato më largohen.

Të ndriçojë drapërin
gjithë natën jashtë
hënën do ta bëj
kapele me kashtë.

Kur u ktheva nga pushimet

Më kumboi në duar çelësi
në pontën e pluhurosur
të shtëpisë.

Hija ime
rikrijohej nëpër mure,
zgjatej mbi suya.

Fikusi
nxori gjethet e reja
duke më qortuar
për mungesat e mëdha.

I hapa
dritaret e mbuluara me perde

kur dhoma
për një rreze dielli ishte tharë.

Në ajrin e pastër
kanatat u lëkundën
si krahë të bardhë.

Mbi degët e kuqe të vetëtimave
shqiponjat
lëvizën në qilim.

Unë s'i mbylla dritaret

Ato me etje
rrëmbyen zërin tim.

Jonufra

Makinat ikën.

Kapanonet në heshtje
mbledhin kujtimet,
gërmat që shkruajnë
me drojtje emrin tënd.

Gurët shtyjnë gurët,
rrokullisen poshtë në breg.
Fidanët zhvendosen
në hektarët e pjerrët.

Tundën degët portokallet,
u çanë bisqet.
Tundën gjethet limonat,
çelën lulet.

Si një ëndërr
në sytë e tu të mirë
ringjallet toka
nga pjekuria.

Nëpër trupin e saj
janë pleksur dhe shtrirë
rrënjët e pemëve
me duart e mia.

Pak fjalë për plakën Maro

Në më pyesni për të
shikomëni:
fytyra e saj
fle
në sytë e mi.

Ajo i ngjante
nënës sime,
nëna ime
i ngjan asaj.

Tek ti jeton dita

Kur historinë
na rrëfente pa letër,
mbi duart e plagosura
nga lufta
ia ulnim kokat
si fletët e zambakut.

Sa dua ta zgjoj,
sa dua!
T'i tregoj me rradhë
amanetet e gjakut.

Tek ti jeton dita

Erdhi dita
me zërat e ngrohtë,
me mëngjesin që gjallërohet
si syri.

Tek ti jeton ajo,
shoku im,
kur me duart e tua
në vrapin e çdo minute
hap shtigje të shikojmë
një hapësirë të bukur.

Tek ti jeton dita
kur di të krijosh udhë
që sondat ta prekin më shpejt

mineralin e çmuar,
që nxënësit ta njohin më shpejt
mënçurinë e shkencës,
që ligësia t'i zbërthohet më shpejt
njeriut të vogël
në çdo vend.

Tek ti jeton dita.
kur toka
shfaq
fytyrën e saj të gjelbër
në emrin tënd.

Tek ti jeton dita.

Tri minuta në kabinën telefonike

Gjithmonë më shfaqesh
me flokët e gjatë,
kaçurrela,
mbi supin tim,
disa ura dhe qytete larg,
disa pyje dhe lumenj të gjerë
si çiltërsia
që kam njohur
tek ty,
në sytë e zinj.

Gjithmonë më shfaqesh
si në trokitjet e postierit
në xhamin e dritares,
me lajmëthirrjen e thjeshtë me emrin tënd,
si në zhurmat
dhe sinjalet e PT-së
që kërkojnë të lidhin nëpër tela

zërat e njohur
të linjës sonë.

Sa të varfëra
do të ishin ato,
sa të ftohta dhe memece
të mos i jepte një tingull,
një fjalë
edhe dashuria jonë.

Unë pres
te stoli i gjatë i postës
si në takimet
kur na shikonin
vjelëset e portokalleve
dhe shamitë
mbi kokrrat që shkëlqenin

tundnin në erë,
kur na shikonin
shoferët
nga makinat e ngakuara me agrume
dhe në kthesat e lehta
u binin borive.

Unë rri
e pres.

Ti sigurisht do t'i bësh
zërat e lodhur të centralisteve
të më thërrasin
tri minuta
në kabinën
telefonike.

Duke shkruar autobiografinë

Në krye shkrova emrin,
humba për një çast në qetësi.
Ngjitur me zërat e prindërve
pranë zemrës së tyre ai rri.

Pastaj hapa të singertë
një nga një hodha nga jeta.
Vetëm në pak fraza,
vetëm në pak rreshta.

Ditët bashkë u mblodhën
e flasin thjesht tani.

Duke shprehur autobiografinë

në këtë letër të bardhë
me emrin autobiografi.

Aty janë punëtorët,
aty është Fierza.

Duart që më rritën,
dritat që unë nderoja.

Nëpër vise m'u zmadhua rruga
dhe jam më i pastër, më i ri.
Jeta jonë, brezi im,
bëhet rrënjë në histori.

Lidhjet e mia me ty, det

Sytë e ndritshëm
tek ty i lan
agimi

Dhe ja,
dita u zbardh,
dita u zgjua.

Pranë teje
mësova
hapin ta kem dallgë.

Çdo dashuri
e ushqej
me dimensionet e tua.

Lart, o moj, në mal

Flokun pak ta preka,
të zura tek porta,
ik më thoshje, ik
do na shohë bota.

Bota le të flasë,
ç'fjalë do të thotë?
Bora si në hënë
ndrit në syrin tënd.

Do të marr në mal,
cule e këngës sime,
të ma bësh jelekun
me zjarr vetëtime.

Ripërtëritje

Në oborrin e shtëpisë
ishte
thinjur portokalli.

Degë-degë
u përkul mbi pllaka
dhe u ça në brinjë.

Në çdo gjethe
një mal me kujtime
ishin gdhëndur nga malli.

Në fytyrat e tyre
të verdha
rinjoha fëmijërinë.

Afër portokallit
në mëngjesin e ngrohur nga dielli
mbolla filiza të rinj.

Të shtrihem në hijen e tyre,
t'i këpus frutat e ëmbla,
të mos thahen për njerinë.

Sazani

Sazani,
një mal,
kockë e gurë
nga toka jonë.

Vazhdim i zërit
dhe i zemrës sonë.

Ai më thërret me dallgët
duke i përplasur
në muret e forta
të shtëpisë.

E syri im
është

te syri i tij
që çliron në horizont
kaltërsinë nga mjegulla.

Në shkëmbinjtë e zbardhur
nga stërkalat e copëtuara,
në pishat e ashpra mbi buzët e gurëve,
në barin e valëzuar nga duart e erës,
nëpër vite
me rrënjë tek liria.

Sazani,
grushti i detit,
i brigjeve
të mia.

PËRMBAJTJA

Rrugët	3
Për radiorevistën e orës 20	4
Ngjarje familjare	6
Moli Zero	8
Prill	12
Të dielën ra shi	14
Vunoi	16
Ju flas për Pogonin	20
Kthehesha i vetëm në shtëpi	23
Përsëri në Vlorë	25
Sa herë iki me shërbim	28
Meditim në stacionin e Kurudhor	29
E pyeta fqinjën	30
Çast nga Berati	31
Në mbrëmjen e 6 gushtit, 1942	33
Hyrje për një radioreportazh nga miniera «Guri i Kuq»	37
Male	38
Dëshira e fundit e këngëtarit të grupit të Himarës	39
Në ditën e dasmës	40
Nëpër rrugët e tua	41
Njohje	42
Kronikë nga viti 1920	45
Pisha flamur	47
Mandarina	50
Si ta marr ujin	52
Kur më vdiq babai	54
Skicë	56
Në kripore	58
Nga fëmijëria	59
Mbrëmjet e të dielave	60
Vajzat me drapër	62
Kur u ktheva nga pushimet	64
Jonufra	66
Pak fjalë për plakën Maro	68
Tek ti jeton dita	70
Tri minuta në kabinën telefonike	72
Duke shkruar autobiografinë	75
Lidhjet e mia me ty, det.	77
Lart, o moj, në mal	78
Ripërtëritje	79
Sazani	81